



Prishtinë: 30 /01/2009
Kodi i ZRRE-së: V_155_2009
REF: D_067_2007

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji, duke u bazuar në:

1. Dispozitat e Neneve 15 dhe 26 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë,
2. Nenin 28.7 të Kushteve të Përgjithshme për Furnizim me Energji,
3. Nenin 14 të Licencës së Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes,
4. Kërkesën e KEK SH.A për **vazhdimin e vlefshmërisë së Procedurës për identifikimin dhe parandalimin e shfrytëzimit të paautorizuar të energjisë elektrike dhe vazhdimin e vlefshmërisë së Procedurës së Faturimit dhe Leximit të Konsumatorëve shtëpiak** të datës 27 janar 2009,

në seancën e mbajtur më 29 janar 2009 nxori këtë:

VENDIM

- I **I lejohet** KEK SH.A. vazhdimi i vlefshmërisë së **Procedurës për identifikimin dhe parandalimin e shfrytëzimit të paautorizuar të energjisë elektrike** deri me aprovimin e ndryshimeve të së njëjtës e më së largu deri me 31 mars 2009.
- II **I lejohet** KEK SH.A. vazhdimi i vlefshmërisë së **Procedurës së Faturimit dhe Leximit të Konsumatorëve shtëpiak** deri me aprovimin e ndryshimeve të së njëjtës e më së largu deri me 31 mars 2009.

Arsyetim

1. KEK SH.A ka bërë kërkesë për aprovimin e ndryshimeve dhe plotësimeve në **Procedurën për identifikimin dhe parandalimin e shfrytëzimit të paautorizuar të energjisë elektrike** me datë 17 dhjetor 2008, ndërsa ZRRE me shkresën e datës 12 janar 2009 ka bërë komente në këtë dokument dhe mbetet që edhe më tutje të përpunohet dhe përmirësohet kështu që të arrihet te një draft i mirëfilltë për aprovim.
2. Kësaj Procedure si dhe **Procedurës së Faturimit dhe Leximit të Konsumatorëve shtëpiak** iu ka skaduar vlefshmëria me 31 dhjetor 2008 andaj edhe është vepruar si në diapozitiv të këtij vendimi.
3. Ky Vendim nxirret në tri gjuhë: shqip, serbisht dhe anglisht. Në rast të mospërputhjes midis gjuhëve, do të sundojë versioni në gjuhën shqipe.



4. Pala e pakënaqur, mund të paraqesë ankesë kundër këtij vendimi në gjykatën e juridiksionit përkatës, brenda 14 ditësh prej miratimit ose datës së publikimit të vendimit në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.
5. Ky vendim hyn në fuqi datën e lëshimit ose datën e publikimit në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

Bordi i ZRRE-së

Ali Hamiti, kryesues

Nysret Avdiu, anëtar

Theranda Beqiri, anëtare

Përparim Kabashi, anëtar